



## *fq. 2* Vizitë studimore pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (BaFin)

### VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2015 fq. 4

### ZHVILLIME TË TJERA

- » Takimi i gjashtë i Nënkomitetit BE-Shqipëri për tregun e brendshëm dhe konkurrencën dhe takimi i gjashtë i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri fq. 6
- » Konferencë Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit në Shërbimet Financiare fq. 8
- » Trajnimi i 25-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë fq. 9

### LAJMET NGA RAJONI

- » Bjellorusi fq. 10
- » Greqi fq. 10
- » Letoni fq. 10
- » Ukrainë fq. 11

## Vizitë studimore pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (BaFin)

Në datat 23-25 mars 2015, një grup pune me specialistë dhe drejtues të AMF-së zhvilluan një vizitë studimore pranë zyrave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (BaFin) në Bon dhe në Frankfurt. Grupi i punës kryesohej nga Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi. Synimi kryesor i vizitës studimore lidhej me marrjen e përvojës së BaFin në çështje specifike të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe fondeve të investimeve.

Vizita studimore pranë zyrave të BaFin në Bon u fokusua në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve. Programi përmbante trajtime të temave specifike si:

- » Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve të Jetës dhe aspekte të licencimit;
- » Modeli i BaFin për “*stress-testet*”;
- » Kërkesat e raportimit rregullator për tregun e sigurimeve;
- » Mbikëqyrja efektive me bazë rreziku.

Modelet “*stress-test*” përfaqësonin instrumente të mbikëqyrjes sipas *Solvency I* dhe kishin si objektiv kryesor ndërlidhjen e investimeve me aftësinë e shoqërisë për të përballuar luhatjet në këto investime. Aplikimi i modeleve të “*stress-testeve*” fokusohej vetëm në aktivet e shoqërive së sigurimit dhe fondeve të pensionit dhe jo në detyrimet apo kapitalin. Rrjedhimisht dy rreziqet kryesore që identifikonin këto teste ishin rreziku i tregut (*market risk*) dhe rreziku i kreditit (*credit risk*).

Përlllogaritja e rrezikut të kreditit bëhej bazuar në vlerësimin (*rating*) të agjencive ndërkombëtare të vlerësimit. Kështu skontimi i letrave me vlerë bazohej në vlerësimet:

AAA-BBB:	nuk aplikohej skontim;
BB-B:	aplikohej 10% skontim;
CCC-D:	aplikohej 30% skontim;
Për letrat me vlerë të pavlerësuar nuk aplikohej skontim.	

Publikimi i rezultateve të këtyre testeve bëhej nga BaFin në formë agregate për gjithë tregun dhe jo për çdo shoqëri në veçanti. Masat e parashikuara për ato shoqëri të cilat nuk arrinin të plotësonin treguesit teknikë sipas “*stress-testeve*” përfshinin injektimin e kapitalit shtesë, rialokimin dhe diversifikimin e aktiveve, “*hedging*” të investimeve në tregun e kapitalit, etj.

BaFin, të paktën një herë në vit, klasifikonte çdo shoqëri sigurimi bazuar në rrezikun e përgjithshëm neto. Rreziku i përgjithshëm neto përcaktohej nga matrica e rrezikut e cila ndërtohej bazuar në dy dimensionet: impakti i shoqërisë në treg dhe

cilësia e shoqërisë. Indikatorë të impaktit të shoqërisë ishin totali i aseteve dhe niveli i primeve të shkruara bruto. Indikatorë të cilësisë së shoqërisë ishin pozicioni financiar, raportet teknike, si mbulimi i aftësisë paguese dhe treguesi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, raporti i kombinuar, rritja e aktiveve, cilësia e menaxhimit të lartë, etj.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e sistemit të paralajmërimit të hershëm, i cili ishte ndërtuar bazuar në rezultatet e “*stress-testeve*”, parashikimeve vjetore sipas skenarëve të aftësisë paguese, të kapitalit, si edhe raportimeve financiare.

Ekspertët gjermanë nga BaFin prezantuan përshtatjen dhe aplikimin e direktivës *Solvency II*, si një prej sfidave aktuale të tregut të sigurimeve në Gjermani.

Vizita studimore që u zhvillua pranë zyrave të BaFin në Frankfurt u fokusua në mbikëqyrjen e tregut të investimeve. Programi përmbante seanca teknike që u përqendruan në temat specifike lidhur me kërkesat rregulatore për shoqëritë administruese të fondeve të investimit për:

- » Menaxhimin e aseteve;
- » Menaxhimin e likuiditeteve;
- » Menaxhimin e rrezikut;
- » “*Stress-Testet*”;
- » Kërkesat për raportim përfshirë prospektet;
- » Roli dhe funksioni i depozitarit të fondit të investimit.

Kjo vizitë studimore ishte një përvojë e cila do të ndikojë në forcimin e rolit rregullator dhe mbikëqyrës të AMF-së.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 16.75% gjatë periudhës janar-shkurt 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 2.01 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 5.13% duke arritur në 141,650 polica.

Një tjetër tregues i ecursisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 7.56% në krahasim me periudhën janar-shkurt 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.32 miliardë lekë, apo 73.66% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 22.73% gjatë periudhës janar-shkurt 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-shkurt 2014.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 1.16 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shkurt 2015, duke shënuar një rritje prej 35.48% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-shkurt 2015 përbënte 57.88% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 18.32% të tregut të Jo-Jetës;
- » sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 11.79% të tregut të Jo-Jetës.

### Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 20.85% krahasuar me periudhën janar-shkurt të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” i cili zinte 43.10% të sigurimit të Jetës.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-shkurt 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



# ZHVILLIME TË TJERA

## Takimi i gjashtë i Nënkomitetit BE-Shqipëri për tregun e brendshëm dhe konkurrencën dhe takimi i gjashtë i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri

Në datën 5 mars 2015, në Bruksel, u zhvillua takimi i gjashtë i Nënkomitetit BE-Shqipëri për tregun e brendshëm dhe konkurrencën me qëllim shqyrtimin e zhvillimeve legjislativë dhe institucionale të Shqipërisë. Në vazhdim të këtij takimi, si dhe në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, në datën 20 mars 2015, në Bruksel, u zhvillua takimi i gjashtë i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Përfaqësuesit e BE-së vlerësuan progresin e bërë nga Shqipëria në përbushjen e angazhimeve që burojnë nga dokumentet strategjike si: Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2014, si edhe rekomandimet e mëparshme të lëna nga Nënkomiteti i BE-Shqipëri për tregun e brendshëm dhe konkurrencën.

Përfaqësuesit e AMF-së në këto takime, prezantuan ecurinë e tregjeve nën mbikëqyrje duke u fokusuar në zhvillimet legjislativë dhe përafrimin me direktivat respektive të Bashkimit Evropian.

Ndër zhvillimet legjislativë u përmendën:

- » Miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit";
- » Hartimi i ndryshimeve të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit;
- » Hartimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar";
- » Miratimi i disa akteve nënligjore të reja e përmirësimi i atyre ekzistuese, etj.

Në lidhje me fuqizimin e rolit mbikëqyrës të AMF-së u prezantuan projektet e realizuara nga Autoriteti si fillimi i zbatimit të metodologjisë më fokus rrezikun, ecuria për zbatimin e sistemit *Bonus-Malus*, etj.

Në takime u prezantuan edhe çështje që kishin të bënin me forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale të AMF-së, sikurse ishin: miratimi i Ligjit nr. 54/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare"; i ndryshimeve të Ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për

pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura si të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe më miratimi i ndryshimeve të Ligjit nr. 178/2014 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil””, miratime të cilat ishin të nevojshme në mënyrë që Ligji i ri nr. 54/2014, të bëhej plotësisht i zbatueshëm.

Përfaqësuesit e Komisionit Evropian në pyetjet e drejtuara u fokusuan kryesisht në:

- » Tregun e letrave me vlerë, perspektivën e zhvillimit të bursës dhe interesin e investitorëve të huaj në këtë treg;
- » Forcimin e pavarësisë institucionale dhe financiare të AMF-së, si dhe nevojën e rritjes dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale të tij;
- » Parashikimet në lidhje me përfundimin e procesit të miratimit të ndryshimeve ligjore të ligjit për sigurimin e detyrueshëm motorik.

# Konferencë Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit në Shërbimet Financiare

Shoqata Kombëtare e Sigurimit dhe Risigurimit në Rumani (*UNSAR*) - në partneritet me Shoqatën Rumune për Promovimin e Sigurimeve (*APPA*) zhvilluan më 12 mars, në Bukuresht, Rumani, Konferencën e Dytë Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit në Shërbimet Financiare.

Konferenca diskutoi mbi disa iniciativa që mund të ndërmerren për mbrojtjen e konsumatorëve. Kështu u diskutua për:

- » Hartimin e rregulloreve me përmbajtje të tillë që të rindërtojnë besimin e publikut në shërbimet financiare;
- » Krijimin e metodologjive për të studiuar tendencat e konsumatorëve në kërkesat e tyre për shërbime financiare dhe mënyrën se si ata marrin parasysh rreziqet, përfitimet dhe kostot;
- » Edukimin financiar edhe nëpërmjet trajnimeve profesionale të vazhdueshme dhe të specializuara në të ardhmen;
- » Angazhimin e autoriteteve rregullatore për të përmirësuar pozicionin e konsumatorëve dhe për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për të drejtat dhe detyrimet që ata kanë.

Autoriteti Evropian për Sigurimet dhe Pensionet (*EIOPA*), brenda vitit 2016 do të përgatisë disa dokumente bazuar mbi testimin e konsumatorëve të cilat do të adresojnë çështje lidhur me përdorimin e praktikave më të mira në mbrojtje të konsumatorëve dhe inkurajimin e transparencës në tregjet financiare.

Gjatë konferencës u diskutua që tendencat e rritjes së tregjeve duhet të shkojnë paralelisht me rritjen e aftësive të konsumatorëve për t'i lexuar dhe përdorur të dhënat. Gjetja sa më parë e problemeve që tregu mund të ketë, i shërben edhe zgjidhjes sa më të shpejtë të tyre.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë prezantoi iniciativën e tij për krijimin e një grupi këshillimor për mbrojtjen e konsumatorit.

Konferenca u ofroi mbikëqyrësve të sigurimeve dhe profesionistëve të fushës një platformë për të shkëmbyer ide dhe për të diskutuar mbi tendencat e fundit evropiane për mbrojtjen e konsumatorit në shërbimet financiare.

Më shumë informacion mbi Konferencën e Dytë Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit gjendet në [www.consumerprotection.ro](http://www.consumerprotection.ro)



# Trajnimi i 25-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë

Komisioni i Letrave me Vlerë të SHBA-së (*Securities Exchange Commission, SEC*) zhvilloi në datat 16-26 mars, në Washington, trajnimin e 25-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë. Në këtë trajnim merrnin pjesë 148 përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregulatore. Temat e trajtuara nga lektorët paraqitën shumë interes për zhvillimet e rëndësishme që paraqet tregu i letrave me vlerë.

Ndër temat kryesore që u trajtuan, përmendim:

**Rritja e rolit të rregullatorit në tregjet e kapitalit.** Pikat kryesore të kësaj teme ishin kërkesat për një sistem publikimi efektiv për emetuesit e letrave me vlerë, si dhe krijimi i një programi ekzaminimi efektiv për *broker-dealer* dhe këshilltarët e investimit.

**Fondet dhe shoqëritë e investimit.** Në lidhje me këtë temë u trajtua rregullimi i fondeve dhe shoqërive të investimit, mbikëqyrja e tyre me fokus rrezikun, si dhe edukimi i investitorëve si pjesë e rëndësishme për zhvillimin me sukses të tregut të investimeve.

**Ndërtimi i një programi mbi zbatueshmërinë e legjislacionit dhe praktikat më të mira.** Nëpërmjet kësaj teme u diskutua mbi forcimin e hetimit dhe ndjekjes së manipulimeve që bëhen në treg. Rëndësi ju dha kryerjes së investigimit, etapave që ndiqen për kryerjen e tij, bashkëpunimit që duhet të realizohet midis kompanive dhe investitorëve, përgatitjes së një stafi kompetent dhe kërkesat për sjelljen e stafit. Gjithashtu u vu theksi edhe tek rëndësia e hetimit të pastrimit të parave në tregjet e kapitalit.

**Qeverisja e korporatave.** Tema shtjelloi qeverisjen e korporatave duke analizuar teoritë, konceptet dhe principet e saj. Problemi kryesor i trajtuar lidhej me mbrojtjen e investitorëve të huaj (pakicat e aksionarëve dhe kreditorëve) nga shpronësimi i investitorëve të brendshëm (menaxherët dhe aksionarët kontrollues). Zgjidhja e këtij problemi çon drejt rritjes së vlerës së korporatës për investitorët.

**Skema Ponzi dhe mashtrimi me skemat piramidale.** U trajtuan mekanizmat e funksionimit të skemave piramidale, investimet mashtruese dhe trajtimi i skemave piramidale më të njohura në vite, në vende të ndryshme.

**Zhvillimi i Tregut të Letrave me Vlerë.** Temat mbi tregun e brendshëm në SHBA, manipulimi i tregut dhe mashtrimi në kontabilitetin financiar zunë një vend të rëndësishëm. Gjithashtu, u trajtua studimi për Tregtimin e Shpejtë (*Fast Traders*). Objektivi primar i këtij studimi ishte rasti i të mësuarit sesi ekzaminuesit mund të kryejnë një ekzaminim brokeri. Posaçërisht, ky studim shqyrton rastet kundër pastrimit të parave dhe tregtisë së paautorizuar.

Pjesëmarrësit në trajnim u ndanë në grupe të veçanta me tematika specifike trajnimi. Pjesëmarrësit nga AMF përzgjedhën workshop-in “Mbikëqyrja me Fokus Rrezikun”, i drejtuar nga Drejtori i Analizës së Riskut dhe Mbikëqyrjes të SEC në të cilën u diskutuan proceset që duhen ndjekur për të arritur një mbikëqyrje efektive.

# LAJMET NGA RAJONI

## BJELLORUSI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga tregu i sigurimeve të Bjellorusisë, volumi i primeve të shkruara bruto për vitin 2014 arriti vlerën prej 464 milionë euro (7,300 miliardë BYR, monedha lokale), afërsisht 10.14% më shumë se vitin e kaluar.

## GREQI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit (*Hellenic Association of Insurance Companies, HAIC*) në vitin 2014, vlera e primeve të shkruara bruto arriti rreth 3.8 miliardë euro, afërsisht 0.6% më pak nga viti i kaluar.

Në sigurimin e Jetës, kontratat tradicionale të cilat përfaqësojnë pjesën më të madhe të volumit të primeve të shkruara bruto, afërsisht 31.1%, shënuan një normë rritjeje prej 0.4%. Në të njëjtën kohë, primet e shkruara bruto për produktet e lidhura me kuotat e investimeve u rritën me afërsisht 61% më shumë se vitin e kaluar, duke ndikuar shumë tendencën pozitive të sigurimit të Jetës.

Në sigurimin e Jo-Jetës, të gjitha kategoritë e mëdha të sigurimit paraqitën norma negative në rënie, si -13.3% për sigurimin MTPL, -12% sigurimin Kasko dhe -9% sigurimi i pronës. Këto tre kategori të mësipërme llogariten me afërsisht 42% të tregut në total.

## LETONI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të publikuara nga Komisioni i Tregut Financiar dhe Kapitalit, (*Financial and Capital Market Commission – FKTK*), në Letoni, në vitin 2014 volumi i primeve të shkruara bruto arriti vlerën 517.4 milionë euro, afërsisht 9.9% më shumë se vitin e kaluar. Në tregun e sigurimeve në Letoni, sigurimi i Jetës zë 20.6% të volumit total dhe pjesa tjetër prej 79.4% përfaqësohet nga sigurimi i Jo-Jetës.

Në sigurimin e Jetës, produktet e lidhura me kuotat e investimeve u rritën me 45% krahasuar me vitin e kaluar, duke shënuar vlerën 33.7 milionë euro, ndërkohë që vlera e primeve të shkruara bruto për produktet tradicionale të sigurimit të Jetës u rrit me 8.9% duke arritur në vlerën 45.92 milionë euro.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u dominua nga sigurimi i pronës që përbënte afërsisht 17% të të gjithë tregut, sigurimi Kasko afërsisht 16.3% të totalit të primeve të shkruara bruto dhe sigurimi MTPL afërsisht 10.4% të totalit.

Përrjashtimi i 18 kompanive nga Byroja e Sigurimit Motorik ishte ngjarja kryesore e tregut të sigurimit të mjeteve motorike në vitin 2014 në Ukrainë. Njëra prej tyre, kompania e sigurimit CRIMEAN, u largua nga Byroja e Sigurimit Motorik në mënyrë vullnetare, ndërsa të tjerat u përjashtuan për shkak të mungesës së kapacitetit për të paguar tarifën bazë të garancisë për Fondin e Kompensimit të viktimave.

Që nga data 5 nëntor 2014, të gjitha kompanitë anëtare u detyruan të rrisnin tarifën bazë të garancisë që i paguhet Byrosë në vlerën 500,000 euro në përputhje me kursin e këmbimit.

### **Kriza "godet" sigurimet MTPL**

Sipas të dhënave të publikuara nga Byroja e Sigurimit Motorik në Ukrainë, në vitin 2014, kompanitë lokale të sigurimit lidhën rreth 7.5 milionë kontrata për sigurimet MTPL, afërsisht 14% më pak se në vitin 2013. Trazirat politike, si dhe ngjarjet në Ukrainën Lindore dhe aneksimi i Krimesë, ishin disa nga arsyet kryesore të uljes së numrit të kontratave. Kësaj iu shtuan edhe faktorë të tjerë si vjetërimi i parkut të automjeteve, rritja e çmimeve të karburanteve e lubrifikantëve dhe ulja e volumit të biznesit në tregti dhe turizëm.

Me gjithë uljen e numrit të automjeteve të siguruar, vlera e primeve të shkruara bruto të sigurimit është rritur afërsisht 1.2% për shkak të rritjes së çmimit mesatar të kontratës me 16%. Kjo rritje ishte sipas edhe rekomandimit të Byrosë për kompanitë e sigurimit, në muajin qershor të vitit 2014, për të shmangur ofrimin e kontratave MTPL me koeficientë më të ulët.

Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimit u ulën me afërsisht 4.8%. Aktualisht, në tregun lokal të sigurimit të mjeteve motorike, ka 62 kompani sigurimi aktive.